

Shqip

Informacion mbi Bibliotekën Britanike

Çfarë bëjmë ne?

Biblioteka Britanike është biblioteka Kombëtare e Mbretërisë së Bashkuar. Ne kemi koleksionuar prej 250 vjetësh dhe marrim një kopje të çdo veprë që botohet në Britani dhe Irlandë—kështu që mund të thuhet se kujdesemi për një pjesë të madhe të kujtesës së vendit. Ne blejmë gjithashtu botime të rëndësishme nga e gjithë bota dhe koleksioni ynë përmban shumicën e gjuhëve të njohura.

Biblioteka Britanike është një vend i mrekullueshëm për t'u vizituar. Selia jonë madhështore në St Pancras është një destinacion i pasur dhe interesant, i hapur shtatë ditë të javës. Të gjithë janë të mirëpritur të vizitojnë dyqanin, restorantin dhe kafenetë tona. Ka edhe ekspozita, një program argëtues me aktivitete, dhe një galeri ku shfaqen pjesët kryesore të koleksionit tonë, të cilat janë të hapura falas çdo ditë. Për të mësuar më shumë shikoni broshurën *Ekspozita dhe Aktivitete* ose www.bl.uk

Ne kujdesemi për thesarë të tillë si *Magna Carta*, inçizimi i fjalimit të gjyqit të Nelson Mandelës, blloqet e shënimit të Leonardo da Vincit dhe dorëshkrimet e Bitëllsave (Beatles). Njerëzit vijnë nga e gjithë bota për të parë dokumentat historikë dhe kryeveprat letrare në ekspozitat tona dhe për të studiuar koleksionet e mëdha të kërkimit në Sallat tona të Leximit.

Kush mund ta përdorë Bibliotekën?

Të gjithë janë të mirëpritur ta vizitojnë Bibliotekën, të shijojnë ekspozitat tona dhe të marrin pjesë në aktivitetet publike. Megjithatë, për të përdorur koleksionet në Sallat tona të Leximit, duhet të regjistroheni për të marrë Fletëhyrje Lexuesi. Ju lutemi vini re se hyrja në Sallat e Leximit dhe vlefshmëria e Fletëhyrjes së lëshuar do të varet nga nevojat tuaja të kërkimit. Për shkak të presionit mbi shërbimet tona, ne nuk mund të garantojmë hyrjen dhe Fletëhyrja e Lexuesit lëshohet në varësi të nevojës suaj për të parë vepra specifike në koleksionet tona. Për kërkimin tuaj, mund të jenë më të përshtatshme biblioteka ose burime të tjera dhe personeli do t'ju këshillojë si duhet.

Çfarë duhet të di para se të regjistrohem për Fletëhyrje?

Biblioteka Britanike është shumë e ndryshme nga bibliotekat publike dhe universitare:

- Vetëm veprat për referencë të përgjithshme dhe koleksionet aktuale të shkencës dhe biznesit janë në dispozicion në rafte të hapura në Sallat e Leximit.

- Shumica e veprave në koleksionin e Bibliotekës mbahen në magazinë. Sjellja nga magazina në Sallat e Leximit normalisht merr mes 70 minutash (kur janë në ndërtesë) dhe mbi 48 orë (jashtë ndërtesë) në varësi të asaj se ku ndodhen.
- Veprat e mbajtura në ndërtesë duhet të kërkohen para orës 16.00 që të sillen brenda të njëjtës ditë.
- Përpara se të regjistroheni për Fletëhyrje Lexuesi do të ishte e dobishme që të studioni katalogët në internet të Bibliotekës në www.bl.uk për të konfirmuar se ne kemi materialin që kërkonti; mos harroni të sillni me vete të dhënat e veprave që kërkonti të shihni.
- Biblioteka nuk mban kopje të teksteve standarde dhe në përgjithësi nuk është e përshtatshme për studim për projekte universitare.
- Normalisht nuk lejojmë persona nën moshën 18 vjeç, përveçse në rastet kur është e qartë se ekziston nevoja për të parë vepra specifike që nuk gjenden në biblioteka të tjera. Vizitoni www.bl.uk për të dhëna të mëtejshme.
- Nuk mund të nxirrni jashtë vepra nga asnjë prej Sallave të Leximit.

Si të regjistroheni për Fletëhyrje Leximi

Ejani në zyrën e Regjistrimit të Leximit në Katin e Dytë (Upper Ground) në St Pancras, për të plotësuar një formular aplikimi në kompjuter. Është e dobishme të sillni me vete ndonjë dokument që mbështet aplikimin tuaj, psh kartëvizitë biznesi, kartë anëtarësie profesionale apo të dhënat e veprave që dëshironi të shihni.

Duhet të sillni gjithashtu dokument identifikimi që mban nënshkrimin tuaj dhe provon adresën e shtëpisë suaj.

Fletëhyrja juaj do të jetë e vlefshme për një periudhë nga një muaj në tre vjet, në varësi të nevojave tuaja. Për studiuesit e pavarur ne normalisht nuk lejojmë fletëhyrje për më shumë se një muaj, përveçse në rastet kur është e qartë se është e nevojshme. Fletëhyrjet e Lexuesit lëshohen në bazë të Kushteve të Përdorimit të Bibliotekës; kopje të tyre gjenden në zyrën e Regjistrimit të Leximit si dhe në faqen tonë të internetit. Duhet të keni parasysh se nëse nuk i përmbaheni Kushteve të Përdorimit, përdorimi i Fletëhyrjes suaj të Lexuesit mund të pezullohet.

- **Kërkesa për identifikim dhe provë të adresës.**

Për t'u regjistruar si Lexues, ose për të rinovuar apo zëvendësuar Fletëhyrjen e Lexuesit, duhet të tregoni **dy** forma identifikimi; një që tregon nënshkrimin tuaj dhe një që tregon adresën tuaj të shtëpisë. (Ne duhet të shohim dokumenta **origjinale** dhe nuk mund të pranojmë fotokopje, fakse, printime nga interneti apo filiali i bankës).

Ju lutemi vini re se faturat e shërbimeve, llogaritë bankare/të shoqërive të ndërtimit, të kartave të kreditit, deklaratat e zyrës së Taksave dhe Doganave, librezat e pensionit shtetëror, librezat e ndihmës /kredisë familjare apo rroga **nuk mund të jenë më të vjetra se tre muaj.**

Ne nuk mund të lëshojmë Fletëhyrje Lexuesi pa të dyja format e identifikimit—nuk mund të bëhet asnjë përjashtim. Kërkesat tona për identifikim mund të ndryshojnë, nëse nuk jeni të sigurt për atë që duhet të sillni, ju lutemi kontaktoni: reader-registrationwbl.uk. Format e identifikimit janë si më poshtë:

Provë e adresës së shtëpisë.

Duhet të tregoni një nga dokumentat e mëposhtëm që mban emrin dhe adresën tuaj

+

Provë e identitetit tuaj (që përmban nënshkrimin). Duhet të tregoni një nga dokumentat e mëposhtëm që mban nënshkrimin tuaj:

Fatura shërbimesh (Gaz, Energji elektrike, Telefon, Ujë) Deklaratë e Bankës/Shoqërisë së Ndërtimit (jo printime nga interneti apo nga dega e bankës)

Deklarata të Kartës së Kreditit

Fatura e Taksës së Këshillit/Libreza e Qirasë së Këshillit

Deklaratë nga Zyra e Taksave dhe Doganave

Libreza e Pensionit Shtetëror

Librezat e ndihmës /kredisë familjare

Pasaporta (ku adresa është vendosur zyrtarisht nga autoriteti lëshues)*

Kartë e Identifikimit Kombëtar me adresë *

Patentë shoferi me adresë

Leje qëndrimi nga Ministria e Brendshme (Home Office)

Çertifikatë Universiteti për Konvikt (e vulosur dhe nënshkruar nga institucioni)

Liçensa e TV

Liçensë për Armë Zjarri

Politikë Sigurimi Shtëpie

Fletëpagesë e Rrogës (ku tregohen adresat e punëdhënësit dhe punëmarrësit)

Pasaportë*

Patentë shoferi *

Kartë Bankare

Kartë Krediti

Kartë Identiteti Kombëtare *

Kartë Policie/Dogana/Ministri e Brendshme /Urdhri

Liçensë e Mjeshtrove të Detit/Ajrit

- Këto dokumenta mund të përdoren vetëm ose si provë adrese **ose** si provë identiteti. Ato nuk mund të përdoren për të dyja. Ju lutemi vini re se disa

Dorëshkrimet							
--------------	--	--	--	--	--	--	--

Orari i hapjes së galerive të ekspozitave dhe Dyqanit:

H	M	M	E	P	SH	D & Pushimet Publike në Angli
09.30 - 18.00	09.30 - 20.00	09.30 - 18.00	09.30 - 18.00	09.30 - 18.00	09.30 - 17.00	11.00 - 17.00

Oraret janë sipas orës lokale të Mbretërisë së Bashkuar.

Si mund të na gjeni

Tren Stacionet më të afërta të trenit janë St Pancras International, King's Cross dhe Euston.

Stacionet më të afërta të metrosë janë King's Cross St Pancras, Euston dhe Euston Square.

Autobus Autobusët me numër 10, 30, 73, 91, 390 dhe 476 kalojnë pranë ndërtesës së Bibliotekës.

Makinë/Motorçikletë/Biçikletë

Vend-parkimet më të afërta janë në rrugën 'Marchmont Street' dhe 'Judd Street' dhe parkimi me sahat gjendet në 'Ossulton Street'. Ka një vend të mbuluar për biçikleta në Piazza.

www.bl.uk

T +44 (0)843 208 1144